

ROLI I BASHKISË TIRANË NË VETPËRMBUSHJEN E QYTETARËVE TË SAJ

KAPITULLI I PUNËSIMIT

Në 'Raportin e Lumturisë' për 2019-ën nga OKB, Shqipëria renditej e fundit në Evropë. Për vitin 2019, statistikat e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave treguan se 3% e shqiptarëve zotërojnë gjithsej rreth 4,1 miliardë euro në depozita bankare, ndërsa 97% e individëve zotërojnë rreth 3,2 miliardë euro. Ndërsa raporti i fundit i DASH tregon se niveli i korrupsionit në Shqipëri është alarmant. Raporte këto që numerifikojnë ndjenjën e papërbushjes që kaplon individët e shoqërisë shqiptare.

Një ndër elementët më të rëndësishëm të vetpërbushjes është punësimi. Puna është një element që shërben si spirancë në jetën tonë, vetërregulluese jo vetëm emocionale, por dhe shpirtërore. Puna, fundja, është mjeti që na lejon të plotësojmë çdo nevojë tjetër të jetës sonë.

Një raporti i Institutit të Vienës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (Wiiw) dhe Bankës Botërore për tendencat e punësimit, tregon se në Shqipëri rreth 55% e firmave deklarojnë vështirësi në punësim si pasojë e mungesës së aftësive dhe eksperiencës. Duke iu referuar INSTAT, papunësia mes të diplomuarve në 2019 ishte në nivele më të larta se papunësia mesatare në ekonomi, me 12.3%.

Bashkia e Tiranës mund të luajë një rol vendimtar në adresimin e hendekut midis të diplomuarve dhe tregut të punës duke zbatuar një strategji gjithëpërfshirëse për përshtatjen e vendeve të punës. Tirana vazhdon të rritet si qendra ekonomike e Shqipërisë, ndaj dhe kërkesa për profesionistë të kualifikuar po rritet. Duke u përqendruar në përshtatjen e punës, zhvillimin e aftësive dhe lidhjet midis punëdhënësve dhe të diplomuarve, Bashkia e Tiranës mund të adresojë mungesat e aftësive specifike për sektorë të caktuar, duke përmbushur kështu një kriter të rëndësishëm të *acquis*.

Si fillim, Bashkia e Tiranës mund të krijojë një platformë online për përshtatjen e vendeve të punës që lidh të diplomuarit me punëdhënësit. Kjo platformë mund të shërbejë si një qendër ku të diplomuarit mund të krijojnë profile, të ngarkojnë CV-të e tyre dhe të marrin rekomandime pune të personalizuar bazuar në fushën e tyre të studimit, aftësitë dhe aspiratat e karrierës. Platforma mund të përdorë algoritme AI për të përputhur të diplomuarit me mundësi pune relevante të postuara nga biznese lokale, institucione qeveritare dhe OJQ. Punëdhënësit gjithashtu do të kenë mundësi të kërkojnë kandidatë bazuar në kritere të veçanta, si kualifikimet, përvoja dhe aftësitë e buta. Kjo iniciativë do të thjeshtojë procesin e rekrutimit duke reduktuar hendekun e informacionit midis punëdhënësve dhe kërkuesve të punës. Mbi të gjitha, ajo është në përputhje me *acquis-in*, duke zgjidhur me inovacion dixhital një problem të vjetër të shoqërisë.

Për të përmirësuar kalimin e të diplomuarve nga akademia në punësim, Bashkia e Tiranës mund të krijojë një program praktikash në bashkëpunim me bizneset lokale. Bashkia ka një eksperiencë të mirë me ofrimin e internshipeve brenda institucionit vet, përvojë kjo që mund ta avancojë në institucione private. Programi mund të ofrojë internship të paguar, veçanërisht në industri ku janë identifikuar mungesa aftësish. Kompanitë lokale që marrin pjesë në program si këmbim mund të përfitojnë lehtësira tatimore ose subvencione nga Bashkia.

Një veprim tjetër që Bashkia mund të ndërmarrë është krijimi i një programi mentorimi midis të diplomuarve dhe ish-studentëve të suksesshëm të universiteteve të Tiranës që punojnë në industri. Të diplomuarit mund të lidhen me mentorë bazuar në fushën e tyre të studimit dhe interesat e karrierës. Mentorët mund të ofrojnë udhëzime për zhvillimin e karrierës, ndihmojnë të diplomuarit të orientohen në tregun e punës dhe të japin njohuri për tendencat e industrisë. Bashkia mund të bashkëpunojë me universitetet për të krijuar një program të strukturuar mentorimi që përfshin takime të rregullta dhe aktivitete *networking*.

Duke zbatuar këto iniciativa, Bashkia e Tiranës mund të luajë një rol vendimtar në lidhjen e të diplomuarve me tregun e punës. Këto programe jo vetëm që rrisin punësueshmërinë, por gjithashtu do sigurojnë që forca punëtore lokale të jetë e përgatitur mirë për të përmbushur kërkesat e ekonomisë në zhvillim të qytetit. Gjithashtu, ato janë praktika të njohura në vendet e BE-së, çka lehtëson vënien në praktikë të *acquis*.